

I nderuar zoti Kryetar,
Të nderuar deputetë,

Viti i kaluar ka qenë një vit sfidues për të gjithë ne, pasi u ndeshëm me një realitet të paprecedent që ridimensionoi tërësisht marrëdhëniet shoqërore kudo në botë.

Megjithatë, së bashku me pasigurinë, pandemia solli ndër të tjera ndërgjegjësimin se asnjë lloj zhvillimi nuk mund të shkojë përpara pa njeriun.

Dhe shpresoj që ky ndërgjegjësim dhe kjo përvojë e jetuar gjatë këtij viti të gjatë dhe të vështirë të shërbejë për një qasje të re në marrëdhënien midis njeriut dhe teknologjisë.

Gjatë këtij viti u bëmë dëshmitarë të mbushjes së hapësirave të lëna bosh fizikisht me platformat virtuale. Ishte pikërisht falë teknologjisë që distancimi mbeti vetëm fizik, dhe jo social, dhe sallat e mbledhjeve u zhvendosën në hapësira virtuale.

Megjithatë, sa më sipër, sollën me vete detyrën e vështirë për Zyrën e Komisionerit për të adresuar problematikat që lindnin nga ky realitet i ri dhe që, nëse nuk shoqërohej me masa të përshtatshme mund të kthehej në cenim për demokracinë pasi prekte drejtpërsëdrejti të drejtat themelore të njeriut.

Në këtë këndvështrim, Zyra e Komisionerit u përpoq të vinte piketat për maksimizimin e përdorimit sa më efektiv të teknologjisë duke mbrojtur njëkohësisht të miturit, të drejtat e punëmarrësve, lirinë e arsimimit, cilindo subjekt të mbrojtjes së të dhënave.

Duke mos e ndërprerë në asnjë rast veprimtarinë – *përkundër praktikës në shumë vende evropiane*, Zyra e Komisionerit përshtati burimet e saj për garantimin e mirëfunksionimit të institucionit, për të përmbushur me përgjegjësi të gjitha detyrimet ligjore.

E drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale, si dy nga të drejtat dhe liritë themelore, janë parakushte për një demokraci funksionale, shoqëri dhe ekonomi të zhvilluar dhe institucione të përgjegjshme.

Zyra e Komisionerit është e vetëdijshme se standardet për respektimin e tyre nuk mund të funksionojnë pa ndërgjegjësimin e ndërveprimin me publikun, pa një administratë publike llogaridhënëse e me integritet dhe pa një sektor privat modern e eficient, që përbën gjeneratorin e zhvillimit.

Pavarësisht ndikimit fillestar që realiteti i ri pati në realizimin e të drejtës së qytetarëve për qasje në informacionin me karakter publik, duhet thënë se Autoritetet Publike, përgjithësisht, u përshtatën me këtë situatë të re.

Statistika e trajtimit të 715 ankesave gjatë 2020 është tregues i qartë, por jo vetëm, i vendimmarrjes së drejtë të Zyrës së Komisionerit për të mos cenuar/kufizuar për një periudhë kohore ushtrimin e kësaj të drejte.

Megjithatë, mbetet ende pikë e dobët për Autoritetet Publike, fakti se 70% e ankesave marrin zgjidhje gjatë procesit të hetimit administrative nga Zyra e Komisionerit.

Neglizhenca – në shumicën e rasteve; mos funksionimi dhe/ose mos bashkëpunimi i duhur i brendshëm institucional; por edhe mos orientimi i duhur në trajtimin ligjor të kërkesës, janë disa prej problematikave kryesore të konstatuara në këtë drejtim.

Vendimmarrja e Komisionerit ka qenë e fokusuar në çështje me interes të gjerë për publikun:

- trajtimin e konceptit të “konfidencialitetit” të informacionit publik;
- për menaxhimin e situatës së pandemisë nga Autoritetet Publike shëndetësore;
- për mjedisin dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane apo për kontratat e partneritetit publik-privat në këtë fushë.

Gjatë procesit të shqyrtimit të ankesave janë kostatuar ndër të tjera problematika që kanë të bëjnë me:

- vështirësi në trajtimin e kërkesave sipas ligjit, kushtëzuar nga situata e pandemisë;
- ndryshim i koordinatorit për të drejtën e informimit dhe akses i kufizuar në strukturat e tjera të AP;
- delegim i kërkesave në struktura të tjera të AP, duke anashkaluar koordinatorin dhe procedurën ligjore;
- paqartësi për trajtimin e konceptit të konfidencialitetit në kontratat publike (trajtim jo në përputhje me parashikimet e nenit 17 të LDI);
- tendencë e kërkuesve për të përdorur dispozitat e LDI përtej objektit dhe qëllimit të tij, si: krijimi dhe/ose përpunimi i statistikave të reja; marrja e shërbimit si detyrë funksionale e AP dhe jo ushtrimi i të drejtës sipas LDI.

Komisioneri ka dalë me 35 vendime gjatë vitit 2020.

Programi i Transparencës është instrumenti kryesor për Autoritetet Publike për mirëqeverisjen dhe kontrollin e publikut në mirëfunksionimin e tyre.

Dy monitorime online janë zhvilluar gjatë 2020 në 97 institucione qendrore dhe në ato të varësisë, si dhe organet e vetëqeverisjes vendore.

- Konstatohet, jo pa shqetësim, se transparenca jo gjithnjë përbën prioritet në veprimtarinë e AP. Organizimi i duhur administrativ, burime njerëzore të mirëtrajnuara dhe burime financiare të përshtatshme janë të domosdoshme për këtë qëllim. Nga ana tjetër, asistencja e Zyrës së Komisionerit nuk ka munguar dhe nuk do të mungojë në asnjë rast.
- Janë 22 Rekomandime të Komisionerit për zbatimin e detyrimeve ligjore për Programin e Transparencës gjatë 2020, kryesisht për organet e vetëqeverisjes vendore.

Me qëllimin për të përmirësuar më shumë ndërveprimin mes qytetarit dhe AP në funksion të transparencës, në zbatim të përcaktimeve ligjore, Komisioneri miratoi në 18.12.2020 modelet e reja të Programit të Transparencës dhe Regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve, afati i zbatimit të të cilave është 30 qershor 2021.

Zyra e Komisionerit, pavarësisht vështirësive objektive, zhvilloi një aktivitet intensiv inspektimesh, monitorimesh dhe trajnimesh (online, kryesisht) për përmbushjen e objektivave të saj dhe detyrat e vendosura nga Rezoluta e Kuvendit.

Më lejoni të ndaj me ju edhe një lajm të mirë. Institucioni është zgjedhur anëtar i Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit, organizata homologe e Asamblesë Globale të Privatësisë – Konferencën e 41-të Ndërkombëtare të së cilës organizuam në tetorin e 2019. Ky është vlerësim për përpjekjet e vendit, në përgjithësi, në këtë fushë dhe padyshim, për veprimtarinë e institucionit në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Mbrojtja e të dhënave personale, është një sfidë shumëplanëshe, e cila bazohet në balancën e drejtë mes zhvillimeve ekonomiko-shoqërore dhe respektimit të kësaj të drejte.

Situata me pandeminë, natyrshëm, që rifokusoi edhe objektin e veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit përgjatë vitit 2020, në realizimin, kryesisht të inspektimeve në kontrollues publik/privat që operojnë në sektorin shëndetësor dhe në sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Në anën tjetër, vëmendje iu kushtua trajtimit në kohë dhe me përgjegjësi të ankesave të qytetarëve, në total 308.

Funksionet mbikëqyrëse të autoritetit u zhvilluan në mënyrë të kombinuar, online dhe në terren, të cilat kishin në vëmendje masat e sigurisë në përpunimin e të dhënave personale për krijimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) – në rastin e inspektimeve në kontrolluesit TIK.

Ndërsa për sektorin shëndetësor, fokusi ishte në zbatimin e detyrimeve ligjore të ndërthurura me 4 udhëzues për përpunimin e të dhënave personale (dhe sensitive) të hartuar në funksion të menaxhimit të situatës së krijuar nga pandemia.

Për të dy këto kategori inspektimesh, Zyra e Komisionerit ka paraqitur Kuvendit një Raport të posaçëm, disa nga gjetjet e të cilit janë pasqyruar edhe në Raportin Vjetor 2020. Në mënyrë të përmbledhur përmendim:

- Mangësi të theksuara në aspektin tekniko-organizativ (akteve rregullatore për proceset përpunuese);
- çështje që kanë të bëjnë me aksesin e kufizuar në përpunimin e të dhënave personale, kryesisht ato sensitive;
- ndarje e paqartë e përgjegjësive ligjore “kontrollues”- “përpunues”;
- mungesë të trajnimeve të stafit dhe në përgjithësi, mungesë strategjie/plani për zbatimin e SMSI apo të karakterit infrastrukturor;
- çështje që kanë të bëjnë me informimin e subjektit të të dhënave dhe me ruajtjen e konfidencialitetit në këtë proces.

Nga ana tjetër, veprimtaria mbikëqyrëse është zhvilluar edhe në fusha të tjera si dhe mbi bazë të trajtimit të ankesave.

Për adresimin e problematikave të sipërpërmendura, por edhe nevoja për të pasur një kuadër të ri ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim që qytetarëve shqiptarë tu garantohen standardet më të larta në këtë fushë, prej datës 1 tetor 2020 është duke u zbatuar Projekti i Binjakëzimit, financuar nga Bashkimi Evropian, i cili ka si qëllim të asistojë institucionin në procesin e përafrimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren e Përgjithshme Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Direktivën e Policisë, njëkohësisht dhe zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve administrative të institucioneve shqiptare.

Nga ana tjetër, vijon puna për procedurat e nënshkrimit të Protokollit ndryshues të Konventës 108 të Këshillit të Evropës deri në ratifikimin e këtij instrumenti nga Kuvendi i Shqipërisë.

Nisur nga përvoja pozitive e Rekomandimeve Unifikuese të Komisionerit, edhe këtë vit, është vijuar me dhënien e Rekomandimeve të kësaj natyre për institucionet publike në:

- caktimin e personit të kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe;
- publikimin e “politikave të privatësisë” në faqet e tyre zyrtare të internetit;

Nga ana tjetër, gjatë vitit 2020, përpjekjet nuk janë ndalur vetëm në arritjen e standarteve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, por edhe në angazhimin për plotësimin e kuadrit ligjor për të drejtën e informimit si miratimi në parim i Konventës së Këshillit të Evropës për aksesin në dokumentet zyrtare dhe transpozimi në legjislacionin shqiptar të Direktivës 2019/1024 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.

Ne synojmë të pasurojmë kuadrin ligjor edhe në një aspekt tjetër të rëndësishëm për garantimin e të drejtave të qytetarëve, duke adresuar një problematikë të konstatuar gjatë veprimtarisë së institucionit – fenomenin shqetësues të përdorimit të të dhënave personale nëpërmjet thirrjeve/komunikimeve të pa kërkuara.

Zyra e Komisionerit inicioi punën për hartimin e projektligjit “Për krijimin e regjistrit të komunikimeve tregtare të pa kërkuara”, duke vlerësuar se ky është mekanizmi i duhur mbrojtës që i jep zgjidhje afatgjatë rregullatore këtij sektori të ekonomisë digjitale.

Nuk mund të lë pa përmendur që edhe këtë vit, Zyra e Komisionerit ka patur një bashkëpunim të frutshëm me organizatat e shoqërisë civile, ku përveç organizimit të aktiviteteve të përbashkëta me fokus forcimin e të drejtës për informim, ka konsultuar rekomandimet e tyre duke i reflektuar në veprimtarinë e saj.

Standardet bashkëkohore për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nuk mund të kuptohen pa një institucion me nëpunës të trajnuar, motivuar dhe aktiv. Në këtë mënyrë, do të rritet eficienta në veprimtarinë e institucionit, për një performancë në ritje në shërbim të qytetarëve.

Në përfundim gjej rastin të falenderoj Kuvendin për ndihmën dhe mbështetjen e vazhdueshme që i jep Zyrës së Komisionerit.

Ju faleminderit.